



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 7 mars 2017

Numri i lëndës: 2015-15

Dorđe Šmigić

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 7 mars 2017, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Noora Aarnio, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi me 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa ishte regjistruar me 23 dhjetor 2015.

II. FAKTET

2. Faktet e mëposhtme paraqitet nga të dhënat, të cilat ankuesi i ka ofruar: Në disa raste në vitin 2014, dera e përparme e shtëpisë së tij ishte thyer. Në maj të vitit 2015, shtëpia e tij ishte thyer dhe ankuesi dhe familja e tij ishin grabitur.
3. Ankuesi thotë se i kishte raportuar krimet në Policinë e Kosovës dhe se Policia kishte marrë deklaratat në lidhje me ato ngjarje. Që nga atëherë ankuesi nuk ishte kontaktuar nga Policia.

III. ANKESAT

4. Ankuesi pohon se të drejtat e tij në mbrojtjen e pronës dhe të barazisë para ligjit janë shkelur.
5. Dispozitat që duket se janë të rëndësishme për këtë ankesë përfshijnë nenin 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), nenin 14 të Konventës, nenin 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe nenin 26 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike.

IV. LIGJI

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të zbatoj instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendosë nëse do të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullën 29 të Rregullores së Punës.
8. Sipas Rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e gjyqësisë, policisë dhe doganave.
9. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me mungesën e supozuar të përgjigjes së duhur nga Policia e Kosovës. Ankuesi nuk

argumenton e lërë më tregon se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në këto çështje.

10. Nga kjo del se ankesa nuk hyn në kuadër të mandatit të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të Rregullores së vet të Punës dhe OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë që të shqyrtoj këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të Rregullores së vet të Punës dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese